



Titulli i projektit

Rikonstruksioni i lulishtes “28 Gushti”, Bajram Curri

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Bashkia Bajram Curri

Buxheti i paravlerësuar

40,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Qyteti i Bajram Currit, sipas regjistrimit të gjendjes civile, ka një popullsi prej 8250 banorësh, të ndarë në tre lagje, përkatësisht “28 Gushti”, “Dardania” dhe “Partizani”. Lagja “28 Gushti” ka rreth 1300 banorë, rreth 240 familje dhe ndodhet në qendër të qytetit, ku janë të vendosura institucionet kryesore shtetërore, si bashkia, nënprefektura, sigurimet shoqërore, Zyra e Punës dhe administrata e Këshillit të Qarkut. Në këtë lagje, edhe pse e vogël, mungojnë kushtet minimale të hapësirave publike midis pallateve. Në një sipërfaqe prej 600 m<sup>2</sup>, banorët nuk gëzojnë një mjedis sipas standardeve të pranuar për një jetë komunitare të kulturuar. Mungojnë hapësirat e gjelbërta, rrugët midis pallateve, trotualet dhe ndriçimi. Banorët e kësaj lagjeje dhe sidomos fëmijët e të moshuarit, nuk kanë vende të përshtatshme për t'u çlodhur dhe argëtuar. Për fëmijët mungojnë këndet e lojrave dhe hapësirat për të kaluar kohën e lirë dhe pa u rrezikuar. Nuk ka patur investime të mëparshme në këtë lagje. Projekti është një nevojë e komunitetit dhe si e tillë është në përputhje me studimin e Zonës Funksionale Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivat specifikë të projektit përfshijnë:

1. Përmirësimin e kushteve të komunitetit për çlodhje dhe argëtim në lagjen “28 Gushti”, qyteti Bajram Curri.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e ambjenteve publike.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit përfshijnë:

1. Sipërfaqe të gjelbërta të shtuara në mjediset publike të lagjes “28 Gushti”;
2. Mjedis të përshtatshme për lëvizjen e banorëve dhe ndriçimin e lagjes “28 Gushti”;
3. Sipërfaqe çlodhëse të shtuara për banorët e lagjes “28 Gushti”;
4. Komunitet i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Numri i popullsisë përfutuese: rreth 1300 banorë të qytetit Bajram Curri (ose rreth 20% e popullsisë së qytetit Bajram Curri); banorët e njësive të tjera vendore që marrin shërbime të ndryshme.

# PROJEKTI 2



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

1. Sistemimi i terrenit në një sipërfaqe prej 400 m<sup>2</sup>;
2. Ndërtimi i trotuareve në hapësirat midis pallateve të lagjes "28 Gushti";
3. Ndriçimi i lagjes "28 Gushti";
4. Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe vendosja e stolave;
5. Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
6. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Afati i përfundimit të projektit është 3 muaj.

## Maturimi i projektit

Propozimi është në fazën e një projekt-ideje.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Projekt-propozimi përfshihet në funksionet e drejtpërdrejta të bashkisë.

Financuesit e projektit përfshijnë: Bashkinë, komunitetin, biznesin, donatorët vendas e të huaj.

## Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është afërsisht 40,000 Euro.